



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA

MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

KËSHILLI KONSULTATIV
QEVERISJE QENDRORE - VETËQEVERISJE VENDORE

Nr 760 prot

Tiranë, më 18/12 2025

VENDIM

Nr. 9 datë 18.12 2025

PËR

MIRATIMIN E PROJEKTAKTEVE OBJEKT KONSULTIMI NË MBLEDHJEN E
KËSHILLIT KONSULTATIV, QEVERISJE QENDRORE – VETËQEVERISJE
VENDORE TË DATËS 17/12/2025

Këshilli Konsultativ bazuar në Ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, si dhe në VKM nr.244, datë 17.4.2024 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore”, pas shqyrtimit të projektakteve të mëposhtme të mbledhjes së datës 17.12.2025 vendosi:

1. Për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime ne vendimin nr. 649, datë 16.10.2024, Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” të ndryshuar”, propozuar nga Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, u shprehën parimisht dakord me projektvendimin.
2. Për projektvendimin “Për përcaktimin e procedurës dhe mënyrës se shpërblimit te drejte për huadhënien publike”, propozuar nga Ministria e Turizmit, Kulturës dhe

Sportit, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, u shprehën parimisht dakord me projektvendimin.

3. Për projektvendimin **“Për miratimin e normave, standardeve, çmimet bazë dhe praktikat më të mira në fushën e pyjeve”**, propozuar nga Ministria e Mjedisit, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, u shprehën parimisht dakord me projektvendimin.
4. Për projektvendimin **“Për miratimin e Planit Kombëtar për Parandalimin e Krijimit të Mbetjeve”**, propozuar nga Ministria e Mjedisit, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, u shprehën parimisht dakord me projektvendimin.
5. Për projektvendimin **“Për rishikimin e Planit Kombëtar për Energjinë dhe Klimën 2020-2030”**, propozuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, u shprehën parimisht dakord me projektvendimin.

Z. Ervin Demo
Ministër Shteti për Pushtetin Vendor

Z. Aldrin Dalipi
Kryetar/Bashkëkryetar
Shoqata e Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë